

Universiteti i Prishtinës  
*UNIVERSITAS STUDIORUM PRISHTINIENSIS*  
**FAKULTETI I EDUKIMIT**

**Nëna Terezë, 10000 Prishtinë, Kosovë**

Tel: +381-38-244183

URL: <http://www.uni-pr.edu>

Fax: +381-38-244187

Mail: [rektorati@uni-pr.edu](mailto:rektorati@uni-pr.edu)

---

<b>Titulli i kursit:</b>	<b>Mësimdhënia: teoria dhe praktika</b>
<b>Programi:</b>	<b>Master në Mësimdhënie dhe Kurrikulë</b>
<b>Statusi i kursit:</b>	<b>Obligative</b>
<b>Numri i orëve:</b>	<b>3</b>
<b>ECTS:</b>	<b>7</b>
<b>Mësimdhënësia:</b>	<b>Hatixhe Ismajli, prof.asoc.</b>
<b>e-mail:</b>	<a href="mailto:hatixheismajli@yahoo.com">hatixheismajli@yahoo.com</a>

### **Qëllimi i kursit**

Kursi “Mësimdhënia: teoria dhe praktika” synon të trajtojë parimet teorike themelore dhe modelet praktike që u japin mundësinë mësuesve të ndryshojnë praktikën e tanishme të mësimdhënies në dobi të të nxënit produktiv. Kursi përqëndrohet në sintetizimin e njohurive për teorinë dhe modalitetet bashkëkohore të të nxënit dhe ndikimin e tyre në mësimdhënie të suksesshme dhe zhvillim profesional. Në kurs kultivohen shprehitë për gjetjen dhe kërkimin e pavarur të njohurive si dhe zhvillimin e shprehive të nivelit të lartë dhe të zgjidhjes së problemit. Duke u mbështetur në diversitetin e pikëpamjeve dhe llojllojshmërinë e përvojave të mësuesve, gjatë këtij kursi do të diskutohen çështje nga këndvështrimet e ndryshme, si: të mësuarit dhe ndryshimet në arsim, teorinë e të nxënit (bihevjurizmi, kognitivizmi, humanizmi), stilet e të nxënit, metodat bashkëkohore të mësimdhënies, në veçanti metoda sokratike, modalitetet të nxënit aktiv dhe ndërveprues (të menduarit kritik, krijues dhe zgjidhja e problemeve), mësimdhënia e individualizuar, mësimi problemor, mentorimi, të nxënit nga eksperiencia (përvoja), mësimi ekipor, të nxënit gjatë gjithë jetës.

### **Rezultatet e pritura**

Deri në fund të kursit studentët do të jenë në gjendje:

- të analizojnë praktikën e tyre personale duke e ndërlidhur me filozofinë bashkëkohore të edukimit me qëllim të avancimit profesional dhe të ngritjes së cilësisë në mësim;
- të argumentojnë përparësitë e metodave dhe strategjive bashkëkohore të mësimdhënies;

- të shqyrtojnë efikasitetin e mësimit të individualizuar duke pasur parasysh ndryshimet individuale të nxënësve dhe stilet e të nxënësve;
- të reflektojnë rreth aspekteve të mësimit që ndikojnë në zhvillimin e të menduarit kritik dhe zgjidhjes së problemeve;
- të demostrojnë shkathtësi për zbatimin e modaliteteve të të nxënësve bashkëkohor;
- të gjykojnë praktikën bashkëkohore të mësimit të cilat mbështesin strategjitë e suksesshme të mësimit ndërvepruese dhe të nxënësve aktiv.

### Metodologjia e mësimit

Kursi kërkon përfshirjen maksimale të studentëve për punë të pavarur dhe në grupe. Orët e ligjëratave do të realizohen kryesisht nga angazhimi në prezente, detyrat në klasë dhe puna individuale. Organizimi i mësimit mbështetet në mësimin interaktiv përmes zbatimit të teknikave të reja të mësimit duke sugjeruar modele alternative në formë të punimeve praktike dhe të punës kërkimore. Studentët do të diskutojnë dhe reflektojnë për përvojat e mësimit si dhe do të kenë mundësi të shtojnë çështje të ndryshme të cilat gërshetohen me temat mësimore me qëllim të përmirësimit të praktikës mësimore.

### Plani i detajuar i mësimit

Java	Tema	Literatura	Detyrat
1	Të mësuarit dhe ndryshimet në arsim	Fullan, M. (2006), fq.15-35  P.Jarvis, J.Holford, C.Griffin (2003), fq.11-22	Diskutimi dhe nxjerrja e konkludimeve .  Krijimi i grupeve dhe caktimi i temave për prezente. (gjithsej 6 grupe nga 6-7 studentë)
2	Të nxënësve dhe stilet e të nxënësve	P.Jarvis, J.Holford, C.Griffin (2003), fq.22-31,  Grup autorësh (1997), fq. 360-368  Garo, Sofokli (2011), fq.7-9  <a href="http://www.indstate.edu/cirt/id/pedagogies/styles/tstyle.html">http://www.indstate.edu/cirt/id/pedagogies/styles/tstyle.html</a>	Punë në grupe  Identifikimi i stileve të të nxënësve nga çdo anëtar i grupit  Rishikimi i përshkrimeve për stilet e ndryshme të mësimit  Diskutimi në grup

			<p>rreth planifikimit për të nxitur nxënien me stilet e ndryshme të të nxënit.</p> <p>Dhënja e detyrës: <i>shkrimi reflektiv</i> (dorëzohet në javën e 7-të).</p>
3	<p>Metodat bashkëkohore të mësimdhënies</p> <p>/metoda sokratike/</p>	<p>Copeland, M. (2005), fq.8-25, Milat, J. (2005), fq. 35-52</p> <p>Cecil, N.L.&amp; Pfeifer, J. (2011), fq. 11-26</p> <p>Gajo, S. (2002), fq. 168-180</p>	<p>Punë në grupe të përcjellura me debat në klasë</p> <p>Reflektim personal për metodat e mësimdhënies</p>
4	<p>Qasja bihevjuriste e të nxënit</p>	<p>P. Jarvis, J. Holford, C. Griffin (2003), fq.24-32</p> <p>Gredler, M.(2001), fq. 17-29</p>	<p>Prezentimi i punës nga grupi 1</p> <p>Diskutimi në klasë</p>
5	<p>Teoria kognitiviste e të nxënit</p>	<p>P.Jarvis, J. Holford, C. Griffin (2003), fq.32-42,</p> <p>Achman A.F &amp; Conway R.N.F. (1997) fq. 12-36</p> <p>Garro, Sofokli (2011), fq.2-6</p>	<p>Leximi i teksteve të zgjedhura</p> <p>Prezentimi i grupit 2 rreth teorisë kognitive</p> <p>Dhënja e detyrës: <i>Raport/seminari</i></p> <p>Jepen temat e seminarit (dorëzohet në javën e 13 -të).</p>
6	<p>Të nxënit sipas teorisë humaniste</p>	<p>Greene R.R., (2009), fq.19-35, 57-69</p> <p>P.Jarvis, J.Holford, C.Griffin (2003),fq. 31-45</p>	<p>Punë në grupe rreth perspektives praktike të teorisë</p>

		Gredler, M.(2001), fq.203-269	humaniste  Punë individuale: analizë e teorive të të nxënit
7	Diskutimi dhe analiza e shkrimit reflektiv		Dorëzimi i detyrës: shkrimi reflektiv  Reflektim personal për temën dhe përfundimet e nxjerrura  Leximi i 2-3 punimeve dhe diskutimi në klasë
8	Modalitetet e të nxënit bashkëkohor/ të nxënit aktiv, të nxënit ndërveprues, të menduarit kritik dhe krijues, zgjidhja e problemit/	Gredler, M.(2001),fq. 46-59 Stevanovic, M.(2003), fq.57-72	Ligjëratë e shkurtër  Prezentimi në grup lidhur me modalitetet e të nxënit (grupi 3)  Pregaditje për raportin/seminarin
9	Metoda e të nxënit nga përvoja (eksperienca)	P.Jarvis, J.Holford, C.Griffin (2003), fq.53-68	Diskutim për zbatimin e njohurive në praktikë  Prezantimi i temës nga grupi 4
10	Mësimi problemor	Gredler, M.(2001), fq.129-144 Baptiste, S.E. (2003),10-35  Cecil, N.L.& Pfeifer,J. (2011), fq. 125-149	Analiza e një studim rasti  Prezentimi i grupit 4 për çështjet themelore të temës

11	Mësimi i individualizuar	Moore, A. (2000), fq.124-139, Stev Buehl, D. (2009), fq. 21-45	Diskutime nga praktika e pavarur Prezentimi në grup (grupi 5)
12	Mësimi ekipor	Trevor, T. (1998), fq. 39-62 Group work <a href="http://books.google.com">http://books.google.com</a>	Ligjëratë e shkurtër Prezentimi në grup (grupi 6) Detyra në klasë për kontrollimin e njohurive
13	Analiza e raportit/seminarit		Dorëzimi i raportit/seminarit Diskutimi në klasë
14	Mentorimi: arti i të mësuarit dhe të nxënit	Trevor, K.&Mayes A.Sh. (1995), fq.12-45	Leximi i tekstit Diskutime nga praktika mësimore Detyra për zgjidhje individuale
15	Të nxënit gjatë gjithë jetës /zhvillimi profesional i mësimdhënësve/	Kein B. & Osborne M, (2007),fq. 54-98 Lifelong learning <a href="http://amazon.com">http://amazon.com</a>	Shfletimi i literaturës më të gjërë Diskutim për kursin Pregaditje për provim

## Literatura

Achman A.F & Conway R.N.F. (1997). *An introduction to cognitive education:Theory and Applications*, Routledge, London

Buehl, D. (2009). *Classroom strategies for interactive learning*. (3rd edition), International Reading Association. Inc

- Cecil, N.L.& Pfeifer,J. (2011). *The Art of Inquiry: Questioning Strategies for K-6 Classrooms*. Portage&Main Press
- Greene R.R., (2009). *Human behavior theory*, Transaction Publishers, New Brunswick, NJ
- Grup autorësh (1995). *Strategjia e të mësuarit*, Tiranë: Eureka
- Garro, S. (2002). *Sfidat e mësimit*, Tiranë: Erik
- Garro, S. (2011). *Metodologjia dhe praktika e mësimit*, Tiranë
- P.Jarvis, J.Holford, C.Griffin (2003). *The Theory and Practice of Learning*, 2<sup>nd</sup> edition , Kogan Page London & Sterling, VA
- Moore, A. (2000). *Teaching and Learning: Pedagogy, Curriculum and Culture*, Routledge Falmer, London
- Gredler, M.(2001). *Learning and Instruction. Theory into Practice*, 3<sup>rd</sup> ed. Upper Saddle River, NY: Merrill Prentice Hall
- Fullan, M. (2006). *Forcat e ndryshimit: Vazhdim*, Prishtinë: Adea
- Kein B. & Osborne M, (2007), *The concepts and Practices of lifelong learning*, Routledge NY
- Milat, J. (2005). *Pedagogjia-teorija osposoblavanja*, Zagreb: Skolska knjiga
- Stevanovic, M.(2003). *Modeli kreativne nastave*, Rijeka: Andromeda
- Ruggiero, V.R. (2003), *Beyond feelinga: A Guide to Critical Thinking*, Boston: McGraw Hill
- Copeland, M. (2005), *Socratic Fostering Critical and Creative Thinking Circles*, Stenhouse Publishers
- Trevor, T. (1998), *Working with groups*, 2<sup>nd</sup> ed. Macmillan Education Australia, PTY LTD
- Trevor, K.&Mayes A.Sh. (1995), *Issues in Mentoring*, Routledge, NY
- Baptiste, S.E. (2003), *Problem Based-Learning*, SLACK Incorporated, NY: Grove Road
- Vojka-Ismajli, H. (2012). *Teknologjia mësimore dhe të menduarit kritik*, Prishtinë

### **Burime nga interneti**

<http://books.google.com>

<http://amazon.com>

<http://www.bing.com/search?q=theory+and+practice+of+learning&form=QBRE&qs=n&sk=>

## Vlerësimi

Vlerësimi i kursit do të përmbajë vlerësime kumulative të disa komponentëve: frekuentimi dhe diskutimi gjatë pjesëmarrjes aktive në klasë përfshirë shkrimin reflektiv, prezentimin, raportin/seminarin dhe provimin final.

- *Shkrimi reflektiv* - studentët reflektojnë për temën e caktuar në lëminë e mësimdhënies. Shkrimi reflektiv do të ndërtohet mbi bazën e problematikave nga situatat konkrete të marra nga praktika mësimore (4-5 faqe). Kjo detyrë vlerësohet me 10% të pikëve të vlerësimit përfundimtar.
- *Raporti/seminari* - përveç analizës teorike, studentët do të shqyrtojnë edhe rezultatet e nxjerra nga puna kërkimore (10-15 faqe). Punimi i seminarit vlerësohet me 20% të pikëve të vlerësimit përfundimtar.
- *Provimin final (testi me shkrim)* përfshin përmbajtjet e zhvilluara mësimore (nga java e parë deri te e pesëmbëdhjeta). Testi përmban 20 pyetje (totali 100 pikë) dhe secila pyetje vlerësohet prej 0-5 pikë. Tërësia e pikëve të testit jep 45% të pikëve të vlerësimit përfundimtar.

Studenti do të vlerësohet në mënyrë permanente ndërsa nota bazohet në këto performanca:

				Pikët e testit	Nota
1	Aktiviteti dhe puna në klasë	10%	1	91- 100	10
2	Prezentimi	15%	2	81-90	9
3	Shkrimi reflektiv	10%	3	71-80	8
4	Raporti/seminari	20%	4	61-70	7
5	Provimin final	45%	5	51-60	6